



Punuar / Punished / Profili / Received / Delivery		20-04-2022	2	viti / god / year
Organ / Pjesa / Organ / Zjedhja / Org / Unit	Nr. Prot / Nr. Prot / Prot No	Shtjela / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity	
SKRIMSHICK	2255/2022		1/6	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.262/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2477/2021 i datës 16.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.729 e datës 09.08.2021 të parashtruar nga ankuesi ne adresë banimi kundër heshtjes administrative të Komunës së Prishtinës në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 20.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.729/2021 të datës 09.08.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. DETYROHET** Kryetari i Komunës së Prishtinës, që të bëjë zbatimin e vendimit nr: 14-112/01-229786/21 të datës 27.10.2021, duke bërë kompensimin e pagës prej 50% prej datës 11.04.2014 deri në momentin e kthimit të ankuesit në vendin e tij të punës.
- III. OBLIGOHET** Kryetari i Komunës së Prishtinës që të bëjë korrigjimin e paragrafit 4 të arsyetimit të vendimit nr:14-112/01-229786/21 të datës 27.10.2021 si dhe të marrë të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit [REDACTED] i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 03.10.2012 në pozitën “Inspektor i Ndërtimit” në Komunën e Prishtinës, Kryetari i Komunës së Prishtinës më datë 11.04.2014 ka nxjerr Vendim me numër 01.nr.118-87646 me të cilin ka bërë pezullimin parandalues me 50% të pagës deri në vendimin përfundimtar nga gjykata.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda me Aktgjykimin PKR.nr.359/18 të datës 10.11.2020 ka shpallur fajtor ankuesin për shpërdorim të detyrës zyrtare, duke i shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili me pëlqimin e tij është shndërruar në dënim me gjobë në shumë prej 12.000 Euro, i cili do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Pas ankesës së ankuesit kundër këtij aktgjykimi, Gjykata e Apelit të Kosovës –Departamenti Special me Aktgjykimin APS.nr.4/2021 të datës 26.04.2021, ka bërë ndryshimin e Aktgjykimit PKR.nr.359/18 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, duke e liruar nga akuza ankuesin [REDACTED] me të cilin theksohet se nuk është provuar që i njëjti ka kryer vepër penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar.

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ankuesi më datë 05.07.2021 ka parashtruar kërkesë për Kryetarin e Komunës së Prishtinës, për kthim në vendin e punës, dhe kompensimin e mjeteve si në petitum të kërkesës. Në bazë të provave të lëndës ankuesi nuk ka marr përgjigje në kërkesën e tij, kështu që bazuar në heshtjen administrative ankuesi, më datë 09.08.2021 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot: 4139/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet: për kthim në vendin e punës, kompensimin e ndalesës së pagës prej 50% me kamat vjetore prej 8%; kompensimin e shujtave ditore, mbushjeve telefonike, kompensimet sipas kontratës kolektive dhe shtesat sipas vendimit të qeverisë për profesione deficitare etj.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datës 11.08.2021 ankesën e ankuesit e ka dërguar tek Komuna e Prishtinës për përgjigje në ankesë. Më datë 24.08.2021 Këshilli ka pranuar përgjigjeje në ankesë nga Komuna e Prishtinës dhe atë në sasi prej katër (4) faqe.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga data 30.06.2021 deri me datë 28.10.2021 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit pasi që Kuvendi i kishte shkarkuar anëtarët e Këshillit, ndërsa më datë 17.09.2021, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, më datë 16.03.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2477/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin

Civil të Kosovës të datës 17.09.2021 duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankuesit të datës 09.08.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:4139/2021 të datës 09.08.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin A.nr.2447/2021 i datës 16.03.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 11.08.2021; Njoftim i datës 17.09.2021; Flete kthesë e datës 28.09.2021; Flete kthesë e datës 13.08.2021; Formulari për kërkesë apo ankesë i datës 05.07.2021; Kërkesë për kthim në vendin e punës e datës 05.07.2021; Akt Emërimi me numër 01-112-856 i B.I. i datës 03.10.2012; Certifikatë nga Gjykata Themelore në Prishtinë e datës 16.07.2021; Aktgjykimin APS.nr.4/2021 të datës 26.04.2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti Special; Aktgjykimin PKR.nr.359/18 të datës 10.11.2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda; Përgjigje në kërkesë e datës 24.08.2021; Vendimin me numër 01.nr.118-87646 të datës 11.04.2014 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës për pezullim parandalues të ankuesit; E-mail nga M.Ll. për C.Z. i datës 14.04.2022; E-mail nga C.Z. për M.Ll. i datës 13.04.2022; Akt përcjellës i datës 12.11.2021; Vendim me numër 14-112/01-229786/21 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës i datës 27.10.2021; E-mail nga B.I. për C.Z. i datës 14.04.2022; E-mail nga C.Z. për B.I. i datës 14.04.2022;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankueses **është pjesërisht e bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit sipas ankesës së datës 09.08.2021 i cili pretendon që të kthehet në vendin e tij të punës respektivisht kompensimin e ndalesës së pagës prej 50%, ka konstatuar që fillimisht me Aktgjykimin PKR.nr.359/18 të datës 10.11.2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, ankuesi është shpallur fajtor për veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, mirëpo pas ankesës së tij, Gjykata e Apelit e Kosovës–Departamenti Special me Aktgjykimin APS.nr.4/2021 të datës 26.04.2021 ka bërë ndryshimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë duke e liruar nga akuza ankuesin, ku theksohet se **është provuar që i njëjti nuk ka kryer veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar**, bazuar në këtë meqenëse akuza ndaj ankuesit nuk është vërtetuar respektivisht është refuzuar, atëherë, sipas nenit 69 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: **“Nëse nëpunësi përkatës civil më pas rikthehet në shërbim, qoftë për shkak se akuza kundër tij/saj nuk ka mundur të dëshmohet, për shkak të dyshimit ose arsyeve të tjera teknike, ai/ajo duhet të konsiderohet se është pezulluar nga ushtrimi i detyrës”**, rrjedhimisht në bazë të këtij paragrafi të këtij neni periudha e mungesës në punë do të trajtohet si periudhë e qëndrimit në detyrë për të gjitha qëllimet dhe nëpunësi civil duhet të marrë rrogën e plotë dhe mëditjet të cilat ai/ajo do t'i kishte marrë nëse nuk do të ishte pezulluar nga shërbimi.

Kolegji për shqyrtimit dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se lidhur me pretendimin e lartcekur të ankuesit Kryetari i Komunës së Prishtinës ka nxjerr vendimin numër: 14-112/01-229786/21 të datës 27.10.2021 për kthimin e ankuesit në vendin e tij paraprak të punës, andaj ky pretendim ligjërisht pjesërisht është konsumuar pasi që ankuesi sipas deklarimit nëpërmes e-mailit të datës 14.04.2022 është kthyer në vendin e punës, mirëpo Komuna e Prishtinës nuk e ka kompensuar ankuesin në shumën prej 50% sipas pikës II të dispozitivit të vendimit numër: 14-112/01-229786/21 të datës 27.10.2021, andaj Komuna e Prishtinës është e obliguar që ankuesit t'ia bëjë kompensimin e pagës prej 50%, prej datës 11.04.2014 kur është nxjerr Vendimi me numër 01.nr.118-87646 për pezullim parandalues prej 50% të ankuesit deri në zbatimin e këtij vendimi, duke ja kompensuar edhe tatimin në pagë dhe tatimin e trustit pensional.

Sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit që të bëhet kompensimi i mbushjeve telefonike mbi baza mujore, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, referuar Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2008 për Përdorimin e Telefonave (Fiks dhe Mobil) në Qeverinë e Kosovës i cili e rregullon këtë çështje, ka konstatuar se neni 15 i Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2008 për Përdorimin e Telefonave (Fiks dhe Mobil) në Qeverinë e Kosovës, ka përcaktuar që: ***"Shpenzimet e telefonit nuk mund të akumulohen dhe vlera e shpenzimeve në ditën e fundit të muajit"***, bazuar në këtë mbushjet telefonike nuk mund të kompensohen në mënyrë retroaktive, këtë e ka vërtetuar edhe Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin A.nr.1009/15 të datës 14.11.2017 e cila ka vendosur për një rast me objekt të njëjtë të ankesës, rrjedhimisht pretendimi ankimor i ankuesit është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit për kompensimin e beneficioneve si shujta ditore dhe kompensimet sipas kontratës kolektive e zbatuese prej 01 janar 2015, ka konstatuar që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 sipas nenit 82 të saj, ndërsa ka pasur një kohëzgjatje prej tri vitesh siç parashihet me dispozitat e nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, përcaktohet që: ***"Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet"***, mirëpo neni 81 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, respektivisht paragrafi 1 ka përcaktuar që: ***"Nga MPKK, Palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese. Tërheqja nga kjo MPKK, shpallet në Gazetën Zyrtare të Kosovës"***, bazuar në këtë Oda Ekonomike e Kosovës si nënshkruese e kësaj marrëveshje më datë 15.09.2017 ka njoftuar Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale se për arsye ligjore tërhiqet nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive. Neni 82 paragrafi 2 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës përcakton se: ***"Nëse nga MPKK, pasi që i skadon afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga Palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit"***, mirëpo meqenëse njëri nga nënshkruesit e kësaj marrëveshje është tërheq nga zbatimi i saj tre muaj para skadimit e njëjta nuk vlen nga data e tërheqjes, rrjedhimisht nuk ka asnjë dispozita ligjore të kësaj marrëveshje që mund të bëhet kompensimi në mënyrë retroaktive, si rrjedhojë edhe pretendimi i palës ankuese është i pabazuar.

Po ashtu lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit, për kompensimin shtesat sipas vendimit të qeverisë për profesionale deficitare, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që as ankuesi dhe as institucioni punëdhënës në këtë rast Komuna e Prishtinës, nuk ka ofruar asnjë dëshmi që ankuesi para pezullimit ka qenë e përfshirë në listën e personave që gëzojnë shtesë në pagë si profesione deficitare. Po ashtu me Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, është bërë përcaktimi i sistemit dhe strukturës së pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, ndërsa me dispozitat e nenit 14 të këtij ligji është përcaktuar se: ***1. Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut.*** Përkitazi me këtë, duke u bazuar në dispozitat e nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, Qeveria e Republikës së Kosovës, me datë 24.12.2012 ka aprovuar Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet të Tjera të Nëpunësve Civil, përmes të cilës ka përcaktuar kushtet dhe procedurat për shtesat dhe kompensime të tjera mbi pagën bazë të nëpunësve civilë. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore janë shfuqizuar të gjitha aktet nënligjore të cilat kanë rregulluar shtesat dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil, dhe rrjedhimisht edhe Vendimi Nr.02/29 i datës 31.07.2008 dhe Vendimi Nr.02/39 i datës 08.10.2008 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, konstatim ky i dhëne edhe në Raportin Vjetor të Vitit 2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që duke u bazuar në këtë konstatim, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit për realizimin e shtesës në pagë për profesionale deficitare, është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit sipas ankesës së datës 09.08.2021 i cili pretendon për mos kthim në vendin dhe detyrat e punës kolegji ka konstatuar se Kryetari i Komunës së Prishtinës me rastin e nxjerrjes së vendimit numër: 14-112/01-229786/21 të datës

27.10.2021 për kthimin e ankuesit në vendin e punës ka keqinterpretuar Aktgjykimin APS.nr.4/2021 të Gjykatës Apelit të Kosovës –Departamenti Special të datës 26.04.2021, pasi që në paragrafin 4 të arsyetimit të vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës të datës 27.10.2021 potencohet: **“Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda pasi që lënda është kthyer në rigjykim, të akuzuarin e ka gjykuar dhe e ka dënuar por me pëlqimin e të akuzuarit në fjalë është paguar dënimi me gjobë”**, ka gjetur se në Aktgjykimin APS.nr.4/2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës –Departamenti Special të datës 26.04.2021 në faqe tetëmbëdhjetë (18) nga rreshti dy (2) e tutje theksohet, citoj: **“Të akuzuarin për veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK-së me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit do t’i shndërrohet në dënim me gjobë...”**, andaj mbi bazën e kësaj të gjeture Kolegji konstaton se ankuesi nuk ka paguar dënim me gjobë pasi që Aktgjykimi në fjalë nuk është bërë i ekzekutueshëm me faktin që palët kundër këtij Aktgjykimi në afat ligjor kanë ushtruar ankesë, dhe mbi këtë bazë Gjykata e Apelit të Kosovës-Departamenti Special përmes Aktgjykimit APS.nr.4/2021 të datës 26.04.2021 ka vendosur përfundimisht lidhur me aktakuzën e ushtruar ndaj ankuesit dhe të njëjtin e ka liruar nga të gjitha akuzat e ngritura ndaj tij.

Andaj, kryetari i Komunës e Prishtinës obligohet të bëjë korrigjimin e aktit-respektivisht vendimit numër: 14-112/01-229786/21 të datës 27.10.2021 dhe se duhet të jetë i kujdesshëm gjatë elaboratit të kronologjisë së rastit duke mos iu referuar gabimisht apo duke mos tjetërsuar të gjeturat dhe mënyrën e vendosjes në instancë gjyqësore, ndërsa në arsyetim të vendimit të ndryshuar dhe korrigjuar duhet të mbetet vetëm konstatimi sipas Aktgjykimin APS.nr.4/2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës –Departamenti Special të datës 26.04.2021 ku theksohet fakti se ankuesi është liruar nga të gjitha aktakuzat e ngritura ndaj tij.

Bazuar në të lartcekurat, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda numër A.nr.262/2021

Çlirim Zeka

Çlirim Zeka
Procesmbajtës



Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës,
- Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative
- Arkivit të KPMSHCK- së.

